

Tatimet

Tatimet në Zvicër janë të varura nga vendbanimi. Tatimet më të rëndësishme për personat privat janë të ardhurat, pasuria dhe tatimi në vlerën e shtuar.

Sistemi tatimor

Në Zvicër merr shteti, kantonet, komunat dhe kishat e vendit tatim. Njeriu e dallon tatimin direkt dhe indirekt. Tatimet më të rëndësishme direkte janë nga të ardhurat dhe tatimi për pasuri, këto duhet direkt nga personi që ka detyrim tatimor t`i paguaj. Tatimet indirekte ndër të tjera janë, tatimi mbi vlerën e shtuar, tatimi për duhan apo tatimi për naftë. Këto tatime janë në çmimin e mallërave të dhëna. Meqë për shumë tatime kantonet dhe komunat kanë përgjegjësin, ekzistojnë në tatim direkt në mes vendbanimeve dallime të mëdha. Bashkëshortët tatimohen s`bashku.

Tatimi burimor

Të ardhurëve të ri prej jashtëvendit ju ndalet tatimi burimor direkt prej rrogës (tatimi burimor, Quellensteuer). Lajmërimin e bënë për punëmarrësit, punëdhënësi.

- Tatimi është i varuar nga të ardhurat, prej gjendjes familjare (i pa martuar, i martuar, i ndarë) dhe numrit të fëmijëve. Ndryshimet duhet njeriu menjëherë t`i lajmëroj.
- Prej tatimit burimor ka ndalesa të ndryshme shtesë të mundshme, p.sh. për depozitim në shtyllën 3., cinsi për borgje, shpenzimet për sëmundje etj..
- Kush ka pasuri, duhet me paraqitë dhe për këtë të paguaj tatim veçmas.
- Nga të ardhurat prej 120`000 frangave në vit duhet të bëhet një sqarim për tatim (tatim vjetor i rregullt).
- Kush është i martuar me një bashkëshorte apo një bashkëshort me një pasaportë zvicerane apo me vend qëndrim C, duhet duhet poashtu ta plotësoj dhe të paraqesë tatimin (tatim vjetor i rregullt).

Administrata tatimore kantonale, jep informacione të tjera për tatimin burimor.

Administrata tatimore kantonale ose administratat tatimore ndihmojn tutje te pyetjet për tatimin mbi pasurinë.

Tatimet e rregullta

Personat me pasaportë zvicerane apo me vend qëndrim C tatimohen mbi të ardhurat vjetore (ordentliche Besteuerung). Atyre nuk ju ndalet tatimi prej rrogës. Ata duhet t`i plotësojnë fletët për paraqitje të tatimit (Steuererklärung) dhe tatimin ta paguajnë me faturë. Në kantonin Basel-Landschaft, taksat për vitin aktual llogariten në mënyrë të përkohshme paraprakisht (Vorausrechnung). Vlerësimi bëhet vetëm pasi të jetë dorëzuar deklarata tatimore.. Plotësimi i fletëve për paraqitje të tatimit dhe për zviceranet dhe zviceranët është kompleks. Është e këshillueshme që për herën e parë të kërkohet ndihmë. Vendi specifik i dorëzimit (komuna e vendbanimit ose administrata tatimore kantonale) është e shtypur në pjesën e përparme të deklaratës tatimore.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-baselland.ch/sq/parat-dhe-tatimi/tatimet